

**AKTI I THEMELIMIT  
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"AGAÇI GREENS " SH.P.K.**

Sot më datë 26/02/2020 , ortaku themelues :

**GENCI AGAÇI** i lindur më 03/05/1978 në Suk 1. Strum Roskovec Fier (FR), Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit ID nr.H80503014P, me adresë: Ne Suk 1, Strum Roskovec Fier, Shqipëri, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar;

Vendosi themelimin e shoqërise "AGAÇI GREENS "shpk përmes këtij akt themelimi për themelimin e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar ("**Shoqëria**") në pajtim të plotë me ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe në veçanti me ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" ("**Ligji për Shoqëritë Tregtare**") dhe me statutin e saj.

**EMRI I SHOQËRISË, SELIA ZYRTARE, PERSONALITETI JURIDIK DHE  
KOHËZGJATJA**

**Neni 1  
Emri i shoqërisë**

Emri i Shoqërisë është: " **AGAÇI GREENS**" shpk.

Në të gjitha dokumentet, faturat, reklamat dhe publikimet e lëshuara nga Shoqëria, pavarësisht mjeteve të transmetimit, emri i Shoqërisë duhet të paraprihet ose të ndiqet nga të mëposhtmet:

- a.fjalët "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ose "Sh.p.k.",
- b. numri i saj unik i identifikimit (NIPT),
- c. selia e saj zyrtare,
- d. të dhënat nëse Shoqëria është në likuidim.

**Neni 2  
Forma e personalitetit juridik**

Shoqëria është krijuar si një entitet juridik shqiptar me formën juridike të një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (*shoqëri me përgjegjësi të kufizuar*) siç parashikohet në Ligjin për Shoqëritë Tregtare.



**Neni 3**  
**Selia zyrtare, zyrat qendrore**

Selia zyrtare e Shoqërisë është : Njesia Administrative Strum, Fshati Suk 1, Rruga e Strumit, Godina ne zonen kadastrale 3537, nr. Pasurie 107/10, Roskovec Fier, Shqipëri.

Shoqëria mund ta zhvendosë selinë ose të krijojë një seli operative në një vendndodhje tjetër në Shqipëri.

**Neni 4**  
**Kohëzgjatja e shoqërisë**

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pakufizuar.

**OBJEKTI I SHOQËRISË**  
**Neni 5**  
**Objekti i shoqërisë**

Tregtia dhe prodhimi i frutave dhe perimeve me pakice dhe shumice. Tregtia dhe prodhimi i fidaneve, tregtim i plehrave kimike, Import- Eksport etj.  
Veç kësaj, në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari që rezulton ose që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me objektivin e mësipërm.

**KAPITALI FILLESTAR DHE ORGANIZIMI**

**Neni 6**  
**Kapitali fillestar**

Kapitali i fillestar i regjistruar i Shoqërisë është 100.000 (Njeqind mijë) Lekë.

Kapital fillestar i regjistruar perfaqësohet nga 1 (një) kuotë me një vlerë nominale prej 100.000 (njeqindë mijë) Lekë, të cilat do të ngurtësohen në Bankë mbasi shoqëria të regjistrohet ne QKB.

**Neni 7**  
**Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – Organi më i lartë vendimmarrës;



2. Administratorët – Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga administratori i cili zgjidhet për një mandat 5 vjecar me te drejte rizgjedhjeje. Administratori i shoqërisë do të jetë:

- **Genci Petref Agaçi** i lindur më 03/05/1978 Suk 1Strum Roskovec Fier (FR), Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit ID nr.H80503014P, Shqipëri. Shoqëria përfaqësohet para cdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe ne marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili do iu ushtrojë këto të drejta në përputhje me statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

Data: 26-02-2020

**ORTAKU THEMELUES:**

GENCI AGAÇI

